



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
REGJISTRIMIN E AGJENTIT TË SHITJES SË SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME PJESËMARRJE TË HAPUR ME OFERTË
PUBLIKE NË TITUJ TË TRANSFERUESHËM TË MIRATUARA NË NJË VEND
ANËTAR TË BE-SË DHE TË FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE TË
THEMELUARA NË NJË VEND ANËTAR TË BE-SË.

Miratuar me Vendim Bordi nr. 38, datë 31.03.2023
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 59, datë 30.04.2024

Neni 1
Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e kërkesave për regjistrimin e personave juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e marketimit dhe shitjes së aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një shtet anëtar të BE-së dhe të njohura nga Autoriteti. Gjithashtu kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e kërkesave për regjistrimin e personave juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e marketimit dhe shitjes së aksioneve ose kuotave të fondeve të investimeve alternative (FIA) vetëm për klientë profesionistë dhe të kualifikuar të themeluara në një shtet anëtar të BE-së dhe të regjistruara nga Autoriteti.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 101, 102 dhe pikës 2, shkronja “e” të nenit 156, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 3

Përkufizime

Përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato në Ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 4

Kriteret e përgjithshme për regjistrim

Agjenti i shitjes së SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së dhe të njohur nga Autoriteti ose të FIA të themeluara në një vend anëtar të BE-së dhe të regjistruara nga Autoriteti, që të regjistrohet nga Autoriteti duhet:

1. Të jetë një nga subjektet e parashikuara në nenin 101, pika 2, të ligjit nr. 56/2020, i cili përmbush kriteret e kësaj rregulloreje.
2. Të ketë infrastrukturën e nevojshme për të mbajtur regjistrin e pronësisë për investitorët në Republikën e Shqipërisë për të cilët do të kryejë shërbimin e agjentit të shitjes.
3. Të mbajë evidenca për të gjitha shërbimet, veprimtaritë dhe transaksionet që kryen, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për t’i dhënë mundësi Autoritetit të përmbushë detyrat mbikëqyrëse, në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 56/2020.
4. Të marrë të gjithë hapat për të siguruar vijueshmërinë dhe rregullsinë në kryerjen e funksioneve të agjentit të shitjes përmes përdorimit të sistemeve, burimeve dhe procedurave të duhura dhe proporcionale.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

1. Dokumentacioni i nevojshëm për t’u regjistruar si agjent shitjesh është:
 - a) Kërkesa për regjistrim, për të ushtruar veprimtari si agjent shitjesh;
 - b) Kontrata me shkrim me shoqërinë administruese të SIK/administruesin e FIA, për të cilën do të kryejë funksionin e agjentit të shitjes;
 - c) Lista e personave dhe personelit kyç të njësisë që do të kryejë veprimtarinë e agjentit të shitjes;
 - d) Tabela organizative, programi i veprimtarisë që do të kryejë si agjent shitjesh dhe përshkrimi i strukturës organizative të njësisë që do të kryejë detyrat e agjentit të shitjes;
 - e) Dokumente ku përcaktohen SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së dhe të njohura nga Autoriteti ose FIA të themeluara në një vend anëtar të BE-së dhe të regjistruara nga Autoriteti që do të marketohen dhe shiten nga agjenti, përfshirë të dhëna për informimin e investitorëve;
 - f) Informacioni lidhur me planifikimin e përmbushjes së detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Përputhshmërinë në vijimësi me kërkesat mbi regjistrimin në zbatim të ligjit, si dhe të akteve rregullative të miratuara nga Autoriteti në zbatim të këtyre ligjeve;
 - ii. Parandalimin dhe administrimin e konfliktit të interesit në bazë të ligjit, si dhe

- legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga Autoriteti në bazë të këtyre ligjeve si dhe ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshme me qëllim mos cenimin e interesave të investitorëve të SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA, për të cilat do të kryejë funksionin e agjentit të shitjes;
- iii. Parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në lidhje me shitjen e aksioneve ose kuotave të SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA;
 - iv. Kërkesat për transparencën dhe dhënien e informacioneve shpjeguese, në bazë të ligjit, si dhe legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga Autoriteti në bazë të këtyre ligjeve;
 - v. Raportimin lidhur me kërkesat e kësaj rregulloreje;
 - vi. Marketimin e SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA, për të cilat do të kryejë funksionin e agjentit të shitjes;
 - vii. Programin e trajnimit të vazhdueshëm për të garantuar që të gjithë punonjësit janë të trajnuar siç duhet, i kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë dhe pajisen me manuale për procedurat në zbatim të akteve rregullative të miratuara nga Autoriteti;
 - viii. Praktikën e shitjeve të agjentit të shitjes të cilat duhet të jenë të tilla që investitorëve potencialë t'u jepet i gjithë informacioni përkatës, të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm informues për investitorët dhe të informohen për rreziqet;
 - ix. Përshkrimin dhe specifikimin e çdo sistemi TI të përdorur ose që do të përdoret;
 - x. Informacion mbi mënyrën e ruajtjes së të dhënave me qëllim që t'i mundësojë Autoritetit monitorimin e veprimtarisë së agjentit të shitjes.
2. Autoriteti, ka të drejtë që rast pas rasti të vlerësojë dhe t'i kërkojë aplikantit si agjent shitjesh, dokumente apo informacion shtesë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar për regjistrim.

Neni 6

Detyrat e agjentit të shitjes

1. Agjenti i shitjes i regjistruar, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 56/2020, me aktet rregullative të miratuara nga Autoriteti, si dhe vepron me ndershmëri, drejtësi, profesionalizëm, pavarësi dhe vetëm në interes të investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/fondeve të investimeve alternative.
2. Agjenti i shitjes i regjistruar, vepron gjithmonë në interesin më të mirë të investitorëve dhe të SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm /FIA për të cilat kryen funksionin e agjentit të shitjes, si dhe garanton pacënueshmërinë e tregut:
 - a) Duke vepruar në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhshmëri me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
 - b) Duke përdorur aftësitë dhe dijet e nevojshme, duke vepruar me korrektësi dhe me kujdesin

- e duhur;
- c) Duke patur dhe duke përdorur me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtarinë e tij në mënyrë të shëndoshë;
 - d) Duke shmangur konfliktet e interesit, për të garantuar që interesat e investitorëve në çdo lloj sipërmarrje të investimeve kolektive (SIK) me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/fond të investimeve alternative (FIA), për të cilat do të kryejë funksionin e agjentit të shitjes, kanë përparësi dhe qëndrojnë mbi interesat e shoqërisë administruese të SIK/administruesit të FIA, që do të marketojë dhe shesë dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të në bazë të ligjit si dhe legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga Autoriteti në bazë të këtyre ligjeve;
 - e) Duke siguruar trajtim të drejtë, të njëjtë dhe të barabartë të mbajtësve të aksioneve ose kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK) me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/fondet e investimeve alternative (FIA) për të cilat do të kryejë funksionin e agjentit të shitjes;
 - f) Duke siguruar parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
3. Agjenti i shitjes i regjistruar, marketon, përpunon urdhrat e blerjes dhe shlyerjes si dhe kryen pagesa për investitorët në lidhje me aksionet ose kuotat e SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA për të cilat vepron si agjent shitje.
 4. Agjenti i shitjes i regjistruar, mban regjistrin e pronësisë së investitorëve në Republikën e Shqipërisë duke identifikuar për secilin investitor për të cilët do të kryejë shërbimin e agjentit të SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA, vlerën e investuar dhe numrin e aksioneve ose kuotave që zotëron në secilën SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA për të cilën kryen veprimtarinë e agjentit të regjistruar të shitjes.
 5. Agjenti i shitjes i regjistruar publikon në faqen e tij zyrtare të internetit me frekuencë ditore, informacion në lidhje me vlerën neto të aktiveve për kuotë për secilën SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA për të cilën kryen shërbimin e agjentit.
 6. Agjenti i shitjes i regjistruar, bazuar në kontratën me shoqërinë administruese të SIK/administruesin e FIA, për të cilën kryen shërbimin e agjentit, zbaton një procedurë në lidhje me trajtimin e ankesave për secilën SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA.
 7. Agjenti i shitjes i regjistruar, marketon SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA, për të cilat është regjistruar si agjent shitje, mban dhe vë në dispozicion të secilit investitor të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me transparencën, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 56/2020, si dhe i jep investitorëve informacion se si mund të bëhen blerjet dhe shlyerjet në fond dhe se si kryhen pagesat.
 8. Agjenti i shitjes i regjistruar raporton në Autoritet informacionin e përcaktuar në këtë rregullore sipas afateve përkatëse.
 9. Agjenti i shitjes i regjistruar trajnon, pajis me manuale për procedurat e shitjes si dhe teston stafin e shitjes dhe të marketimit minimalisht një herë në vit në përputhje me kërkesat ligjore

dhe rregullatore në fuqi.

Neni 7

Përmbajtja dhe afatet e raportimit në Autoritet

1. Agjenti i shitjes, i regjistruar raporton në Autoritet me frekuencë tremujore informacionin e mëposhtëm:
 - a) Numrin e investitorëve në Republikën e Shqipërisë për të cilët ka kryer shërbimin e agjentit të shitjes së SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA, për të cilën është regjistruar, duke i klasifikuar në investitorë institucionalë dhe individë;
 - b) Vlerën neto të aktiveve të investitorëve në Republikën e Shqipërisë, të ndarë për secilën SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA, për të cilën kryen shërbimin e agjentit të shitjes;
 - c) Vlerën neto të aktiveve për kuotë për secilën SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm/FIA, për të cilën kryen shërbimin e agjentit të shitjes.
2. Agjenti i shitjes i regjistruar, raporton informacionin e mësipërm sipas afateve të përcaktuara më poshtë:
 - a) Për periudhën tremujore me gjendjen e periudhës deri më 31 mars të vitit aktual, deri më 15 prill të vitit aktual;
 - b) Për periudhën gjashtëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 qershor të vitit aktual, deri më 15 korrik të vitit aktual;
 - c) Për periudhën nëntëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 shtator të vitit aktual, deri më 15 tetor të vitit aktual;
 - d) Për fundvitin deri më 15 janar të vitit pasardhës.

Neni 8

Afati i trajtimit të kërkesave, regjistrimi dhe njoftimi nga Autoriteti

1. Autoriteti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për regjistrim e shqyrton atë dhe listën e dokumenteve të depozituara.
2. Autoriteti, nëse vëren se kërkesa e depozituar nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i kërkon subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.
3. Nëse subjekti me kërkesë të argumentuar nuk është në gjendje të paraqesë ndonjë nga dokumentet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, afati shtyhet edhe me 30 (tridhjetë) ditë pune të tjera. Nëse subjekti kërkuar nuk depoziton dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, Autoriteti nuk merr në shqyrtim kërkesën dhe njofton me shkrim ose në mënyrë elektronike subjektin kërkuar.
4. Autoriteti brenda 3 (tre) muajve nga marrja e informacionit të plotë për regjistrimin e agjentit të shitjes, merr vendim për miratimin e regjistrimit ose refuzimin e regjistrimit dhe njofton

subjektin mbi vendimin e tij.

Neni 9

Heqja dhe pezullimi i regjistrimit

1. Regjistrimi i agjentit të shitjes hiqet nëse ky i fundit nuk ushtron veprimtarinë për të cilën është regjistruar për 6 muaj rresht.
2. Në rastet e përcaktuara në nenin 212, pika 2, të ligjit nr. 56/2020, Autoriteti mund të nxjerrë urdhër administrativ që:
 - a) Personi të mos jetë më i regjistruar; ose
 - b) Regjistrimi i personit të pezullohet për një periudhë të përcaktuar, ose deri në ndodhjen e një ngjarjeje të përcaktuar, ose deri në përmbushjen e kushteve të përcaktuara.
3. Para lëshimit të urdhrin administrativ sipas pikës 1, të këtij neni, Autoriteti ndjek procedurën e përcaktuar në nenin 214 të Ligjit nr. 56/2020.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në menjëherë.